

maj 2015

Gogitidze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë - 36862/05

Vendimi 12.5.2015 [Seksioni IV]

Neni 1 i Protokollit nr. 1

Neni 1 para. 2 i Protokollit nr. 1

Kontrolli dhe përdorimi i pronës

Konfiskimi i pasurisë së një nëpunësi civil të fituar gabimisht si pjesë e masave të brendshme kundër korrupsionit: *nuk ka shkelje*

Faktet – Në vitin 2004, kërkuesi i parë, një ish-ministër i qeverisë, u akuzua për shpërdorim detyre dhe zhvatje. Zyra e Prokurorit Publik të Republikës Autonome Ajariane nisi më pas procedimin për konfiskimin e pasurisë kundër tij dhe kërkuesve të tjerë, të gjithë të afërm të kërkuesit të parë, për fitimin e pronës në mënyrë të padrejtë dhe të pashpjegueshme. Në shtator 2004, Gjykata e Lartë Ajariane urdhëroi konfiskimin e gjashtë pronave. Në janar 2005, pas një apeli nga të katër kërkuesit, Gjykata e Lartë e Gjeorgjisë anuloi konfiskimin e një prone dhe la në fuqi urdhrat e konfiskimit për pasuritë e mbetura. Kërkuesi i parë parashtroi një ankesë kushtetuese përmes së cilës kundërshtonte kushtetutshmërinë e dispozitave që rregullojnë procedurat administrative të konfiskimit. Duke e rrëzuar atë ankim, Gjykata Kushtetuese u shpreh se legjislacioni përkatës, i cili kishte filluar të zbatohet në shkurt të vitit 2004, i shërbente interesit publik për intensifikimin e luftës kundër korrupsionit.

Baza ligjore – Neni 1 i Protokollit Nr. 1: Larg të qenit një konfiskim thjesht administrativ, masa e kundërshtuar në çështjen në fjalë lidhet me ekzistencën e mëparshme të një akuze penale kundër një zyrtari publik dhe, për rrjedhojë, përfaqëson për nga natyra e saj një padi civile *in rem* që synon kthimin e pasurive të grumbulluara në mënyrë të padrejtë ose në mënyrë të pashpjegueshme nga zyrtarët publikë dhe rrethi i tyre i ngushtë.

Masa e konfiskimit përbënte ndërhyrje nëpërmjet kontrollit të përdorimit të pronës. Kjo ndërhyrje ishte e ligjshme dhe bëhej për një qëllim legjitim, pikërisht në kuadër të luftës kundër korrupsionit në shërbimin publik.

Për sa i përket proporcionalitetit, Gjykata shqyrtoi nëse procesi i konfiskimit ishte arbitrar. Lidhur me këtë, ajo vuri në dukje se në bazë të standardeve të njohura ndërkombëtarisht për luftimin e veprave të rënda që sjellin pasurim të paarsyeshëm dhe përballë niveleve alarmante të korrupsionit në Gjeorgji në të gjitha nivelet, organe të ndryshme ndërkombëtare, duke përfshirë Komitetin e Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL), kishin këshilluar në mënyrë të përsëritur autoritetet gjeorgjiane për të ndërmarrë masa legjislative për të siguruar konfiskimin e të ardhurave të veprave penale të lidhura me korrupsionin. Autoritetet gjeorgjiane i kishin vënë në praktikë këto udhëzime duke miratuar amendamentin legjislativ të shkurtit të vitit 2004, duke e sjellë legjislacionin gjeorgjian në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare. Në praktikën e mëparshme gjyqësore në këtë sferë, Gjykata nuk kishte parë asnjë problem lidhur me konstatimin e masave të konfiskimit si proporcionale edhe në mungesë të një dënimi që vërtetonte fajësinë e

personave të akuzuar dhe nuk kishte kërkuar prova përtej "dyshimit të arsyeshëm" për origjinën e paligjshme të pronës në fjalë. Ajo kishte vlerësuar gjithashtu se masat e konfiskimit mund të zbatoheshin jo vetëm ndaj personave të akuzuar drejtpërdrejt për vepra penale, por edhe ndaj të afërmeve të afërt që supozohej se zotëronin dhe menaxhonin pronën e fituar padrejtësisht në mënyrë joformale ose që nuk kishin mirëbesimin e nevojshëm. Duke pasur parasysh të gjitha këto aspekte, Gjykata konstatoi, për analogji, se procedurat civile *in rem* në çështjen në fjalë nuk mund të konsideroheshin arbitrare ose që të kishin prishur testin e proporcionalitetit sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1.

Për më tepër, për sa i përket proceseve gjyqësore para gjykatave të brendshme, kërkuarve u ishte kërkuar në mënyrë të rregullt të bënin parashtrime me shkrim dhe të merrnin pjesë në seancat gjyqësore dhe pretendimi i prokurorit publik ishte shqyrtuar siç duhet në dritën e dokumenteve mbështetëse dhe të gjendjes financiare të kërkuarve. Nuk kishte asgjë në mënyrën sesi ishin zhvilluar proceset civile *in rem* që të sugjeronte se kërkuarve u ishte mohuar një mundësi e arsyeshme për të paraqitur çështjen e tyre ose se konstatimet e gjykatave kombëtare ishin njollosur me arbitraritet të dukshëm.

Në përmbledhje, duke pasur parasysh kufirin e gjerë të vlerësimit të autoriteteve gjeorgjiane për të ndjekur politikat e hartuara për të luftuar korrupsionin në shërbimin publik dhe faktin që gjykatat kombëtare u kishin dhënë kërkuarve një mundësi të arsyeshme për të mbrojtur pozicionin e tyre në një sistem akuzator, nuk kishte cenim të ekuilibrit të nevojshëm të drejtë midis interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave themelore të individit.

Përfundim: nuk ka shkelje (me unanimitet).

Këshilli i Evropës/Gjykata Evropiane për të Drejtat e
Njeriut

Kjo përmbledhje e Sekretarisë nuk është detyruese për
Gjykatën

Klikoni këtu për më shumë informacion rreth
[Case-Law Information Notes](#)